



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.105/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada –Gillojani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati , duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dega në Dardanë paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në hapsirë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Dardanë

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 ka vërejtur se në rrugën “Skenderbeu” në Dardanë nëpër drunj, ishin vendosur posterët e kandidatit për deputet Gazmend Abrashi nga koalicioni PDK-AAK-NISMA etj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni PDK-AAK-NISMA etj. me vendosjen e posterit të kandidatit të saj në vend publik, konkretisht në drunj ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pikës b është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se posterët e kandidatit Gazmend Abrashi janë të vendosur në drunj rrugën “Skënderbeu” në Dardanë, nuk qëndrojnë sepse fotografia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk e identifikon se posterit i kandidatit në fjalë a është i vendosur në drunj publik apo privat. Andaj PZAP-i, konstaton se pretendimet e cekura në ankesë janë të pabazuara, për të cilin pretendohet se është bërë shkelja e supozuar, andaj një pretendim i tillë

u vlerësua si i pa argumentuar dhe i pambështetur në prova dhe dëshmi bindëse sepse nga provat e paraqitura nuk mund të shihet se drunjët a janë në pronë publike apo private.

Prandaj paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, më asnjë dëshmi nuk i ka vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë, në mënyrë që PZAP, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.105/2017 më datën 07.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.